



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:128202

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05441691

E.nr.984/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në lëndën e përmbartimit të kreditorit B.F. nga Ferizaj, rr "...", kundër debitorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, sh.a, me seli në Prishtinë, rr "28 Nëntori", nr.4, lagjja Dardania, për pagesën e borxhit dhe shpenzimet e procedurës, më datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën E.nr.984/23, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.984/23, të datës 27.06.2023, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, sh.a, për pagesën e borxhit dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 4,555.12 euro, në bazë të aktgjykimit C.nr.326/17, të datës 03.09.2018.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 26.07.2023, e ka urdhëruar NLB Bank, me seli në Prishtinë, që mjetet në shumë prej 4,555.12 euro, të bartën nga llogaria e debitorit në llogari të autorizuarit të kreditorit.

Andaj, meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

E.nr.984/23, më datë 12.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi